

VENDIM
Nr.1443, datë 31.10.2008

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË PËR
ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL (AZHBR), SI AGJENCIA E PAGESAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 21 të ligjit nr.9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), si agjencia e pagesave, në kuptim të nenit 21 të ligjit nr.9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.

2. AZHBR-ja ka strukturë qendrore dhe struktura vendore, në shkallë qarku.

3. Drejtori i AZHBR-së emërohet, lirohet ose shkarkohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Drejtuesit dhe punonjësit e tjerë të kësaj agjencie, përfshirë edhe ata të strukturave vendore, pranohen sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin për shërbimin civil. Numri i punonjësve të agjencisë është 86 veta.

4. AZHBR-ja është përgjegjëse për administrimin e fondeve të programit për bujqësinë dhe për zhvillimin rural, si më poshtë vijon:

- a) Fondet e Buxhetit të Shtetit, për mbështetje të drejtpërdrejtë të prodhimit bujqësor;
- b) Fondet e Buxhetit të Shtetit, për zhvillimin e infrastrukturës së tregjeve bujqësore;
- c) Fondet kundërparti, të projektit 2KR.

Kriteret e përgjithshme të përdorimit të fondeve kundërparti, të projektit 2 KR, përcaktohen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

5. AZHBR-ja harton planin e veprimit për përafrimin e strukturës organizative dhe të kapaciteteve të saj, menaxhuese dhe teknike, me standardet e akreditimit të BE-së.

6. AZHBR-ja harton dhe propozon projekte, si dhe merr masa për krijimin e administrimit të databazave dhe të logjistikës IT, të nevojshme për funksionimin e saj, sipas standardeve të BE-së.

7. AZHBR-ja do të fillojë të funksionojë më 1 janar 2009.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga Buxheti i Shtetit, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

9. Rregullat dhe procedurat e funksionimit të brendshëm të AZHBR-së, si dhe ndarja e detyrave, përgjegjësi e kompetencave, ndërmjet saj dhe drejtorive rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit (DRBUMK) e aktorëve të tjerë, të sistemit të bujqësisë dhe ushqimit, përcaktohen me udhëzim të veçantë të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

10. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha